

Dr. Vehbetu Zuhejli

Ligji para nesh dhe medhhebi i sehabiut

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2018

Ligji para nesh

Kjo temë ka të bëjë me lidhshmërinë e sheriatit islam me fetë dhe ligjet e mëhershme.

Dihet se pejgamberit s.a.v.s. i ka ardhur shpallja në moshën dyzetë vjeçare, në vitin 611 m.

Dihet se sheriatu islam është përfundim i ligjeve.

Dihet se Kur'ani famëlartë dhe suneti fisnik na kanë treguar për ngjarjet e pejgamberëve të mëhershëm, na kanë paraqitur disa ligje të ligjeve të sheriatit e tyre. Na kanë treguar për ligjet e popujve të mëhershëm si të jehudive e të krishterëve. Parashtrohet pyetja se a kërkohet nga ne të veprojmë me ligjin para nesh?

Në lidhje me këtë tematikë do të flasim në dy aspekte:

E para: Pejgamberi s.a.v.s. para shpalljes a ka qenë dashur të jetë praktikues i ligjeve të mëhershme sepse po të kishte praktikuar ligjet e mëhershme dhe pastaj ato ligje nuk janë shfuqizuar edhe me sheriatin e tij pas zbritjes së shpalljes, sepse atëherë ato do të duhej të gjenin zbatim në mesin tonë.

E dyta: Pejgamberi s.a.v.s. dhe umeti i tij, pas pejgamberisë a duhet të zbatojnë ligjet e ndonjë pejgamberit të mëparshëm?

Para se të sqaroj mendimet e ndryshme të dijetarëve, sipas mendimit tim, e shoh të arsyeshme se nuk ka kurrfarë pengese për t'u lejuar një gjë e tillë sepse nuk ka argument i cili tregon se është absurde që pejgamberi s.a.v.s. të gjej zbatim në ligjet e mëhershme të kohës së para pejgamberisë.

Po ashtu është e lejuar që pas pejgamberisë së Muhamedit s.a.v.s. që Zoti i Lartmadhëruar të kërkoj zbatim të ligjeve të mëhershme prej robërve të tij pa marrë parasysh a të ketë ligjësuar ligj të ri apo të kombinoj mes tyre dhe kjo nuk do ta dëmtonte dhe as nuk do të ishte zëvendësues i tij.

Kështu ne do të flasim për këtë nga aspekti i ndodhisë praktike të saj.

E para: Para pejgamberisë, Muhamedi a.s. a e ka pasur për detyrë të zbatoj ligjet e mëhershme?

Në lidhje me këtë çështje historike, dijetarët janë ndarë në tri drejtime:

- Disa prej tyre, si disa malikijë, si dhe shumica absolute e mutekeliminëve **e mohojnë që ta ketë pasur për detyrë të zbatoj.**
- Disa prej tyre, si hanefijtë, hanbelijtë, Ibn Haxhibi, Kadiju Bejdaviju, e kanë konstatuar **se e ka pasur për detyrë të zbatoj.**
- Disa prej tyre si Gazaliu, Amediu, Kadiju Abdul Xhebarë dhe analitikë të tjerë **bëjnë dallimin:** pasi që nuk ka argument të prerë të zbatimit dhe diçka që na bën me dije me argumente se ka ndodhur zbatimi, e pasi që nuk kemi argument i cili argumenton atëherë në vetvete kundërshtohet, ashtu siç më paraqitet mua.

Ata të cilët konstatojnë zbatimin e ligjit para nesh, kanë dhënë mendime të ndryshme në përcaktimin e cilit ligj para nesh:

- Disa kanë thënë: Është sheriat i Ademit, sepse sheriat i tij është prej ligjeve të para.
- Thuhet se është sheriat i Nuhut a.s., e kjo në bazë të ajetit:

شَرَعَ لَكُمْ مِنَ الدِّينِ مَا وَصَّى بِهِ نُوحًا

“Ai u përcaktoi juve fe atë që i pat përcaktuar Nuhut.” (Esh-Shura : 13)

- Është thënë se e ka zbatuar sheriatin e Ibrahimit a.s., kjo në bazë të ajetit:

إِنَّ أَوَّلَى النَّاسِ بِإِبْرَاهِيمَ لِلَّذِينَ اتَّبَعُوهُ وَهَذَا النَّبِيُّ

“Njerëzit më me meritë për t’u thirrur në Ibrahimin, ishin ata që e ndoqën atë (besimin e tij) dhe ky Pejgamber.” (Ali Imranë : 68)
dhe ajeti tjetër:

ثُمَّ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ أَنْ اتَّبِعِ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا

“Pastaj, ty të shpallëm: “Ndique fenë e drejtë të Ibrahimit.” (En-Nahl : 123)

- Është thënë se e ka zbatuar sheriatin e Musait a.s.;
- Është thënë se ka zbatuar sheriatin e Isait a.s. sepse ai ka qenë pejgamberi më i afërt dhe se i ka shfuqizuar ligjet e mëparshme.

Ka edhe mendime tjera.

Shevkaniu thotë: Mendimi më i drejtë i këtyre mendimeve është se pejgamberi s.a.v.s. e ka zbatuar ligjin e Ibrahimit a.s. sepse ka kërkuar shumë për të duke vepruar çka i është shpallur prej ngjarjeve të tij, siç tregojnë ajetet e Kur'anit, kur pas pejgamberisë është urdhëruar ta pasoj popullin e tij. Urdhërimi për diçka sinjalizon për diçka specifike dhe nëse përcaktohet se e ka zbatuar ndonjë ligj para pejgamberisë, pa dyshim se ka të bëjë për atë.

Hanefijtë e preferojnë mendimin se më së shumti i ngjanë ligjeve të tij (Ibrahimit a.s.) prej ligjeve të cilat i janë raportuar.

Argumentet

Argumentet e mohuesve – Mohuesit të cilët nuk e pranojnë se ka zbatuar ligj të mëhershëm janë argumentuar me dy argumente:

1. Po të kishte zbatuar pejgamberi s.a.v.s. ndonjë ligj prej ligjeve të mëparshme do të na ishte raportuar se çka ka zbatuar, do të kishte qenë e publikuar, do të ishte e kombinuar po me atë ligj ashtu siç ndodh zakonisht me çdo ligj prej ligjeve, mirëpo në këtë drejtim nuk na është raportuar asgjë, pasi që veç na janë të njohura të gjitha ngjarjet e para pejgamberisë.

2. Po të kishte zbatuar ndonjë ligj prej ligjeve të mëparshme atëherë ata pjesëtarë të zbatimit të atyre ligjeve do të mburreshin me ato ligje pas pejgamberisë së Muhamedit a.s dhe do të llogaritin veten e tyre dhe ligjin e tyre mbi Muhamedin a.s.

Replikë

Këto dy argumente replikohen si në vijim:

Po mos të kishte pasur ndonjë ligj prej ligjeve dhe po të mos e kishte zbatuar atë, do të paraqitej kundërshtimi me banorët e zbatuesit e atyre ligjeve kur do të sillnin atë ligj, e kundërshtimi i tij do të kishte dalë haptas dhe do të na ishte transmetuar neve sepse kjo do të plotësonte kushtet për t'u transmetuar deri tek ne, mirëpo deri tek ne nuk na është transmetuar asgjë dhe nuk është prioritarë njëra çështje ndaj çështjes tjetër. Bazuar në këtë: Pretendimet tona kanë argumentim të mjaftueshëm ndaj kundërshtuesve.

Argumentet e vërtetuesve – Vërtetuesit janë argumentuar me dy argumente:

1. Çdo pejgamber i mëhershëm i ka ftuar njerëzit që ta pasonin atë, e pejgamberi bën pjesë brenda përgjithshmërisë së ftesës.

2. Kemi transmetime se pejgamberi s.a.v.s. para pejgamberisë ka kryer veprime të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me logjikën e tij dhe mirësia e tij nuk vjen nga diçka tjetër përpos ligjësisë. Pejgamberi s.a.v.s. është falur, ka kryer haxhin dhe umren, e ka bërë tavaf Qaben, i ka respektuar ato ligje që kanë pasur të bëjnë me Qaben, ka therë kafshë, ka ngrënë mish, i ka nënshtruar kafshët, nuk e ka ngrënë mishin e cofëtines, e çështje tjera. Këto veprime legislative tregojnë se pejgamberi s.a.v.s. ka zbatuar detyra obligative për të cilat nuk kanë qenë nga mendja e tij (por zbatim i ligjit të mëparshëm.

Replikë

Edhe këto dy argumente janë kundërshtuar si në vijim:

Sa i përket argumentimit të parë: Ky arsyetim është i pabazë, pasi që nuk është vërtetuar se është përgjithësim nga fetë e mëparshme, por kanë qenë posaçërisht për ta dhe nuk na është transmetuar në formë të prerë nga asnjë prej pejgamberëve të mëparshëm se i ka thirrur të gjithë njerëzit ta pasojnë atë. Po të presupozonim se na është transmetuar, prapëseprapë kjo është e mundur se ka pasur të bëjë për kohën e pejgamberit s.a.v.s. që pejgamberi s.a.v.s. të shpjegoj ligjet e mëparshme për shkak të vështirësisë së obligueshmërisë duke mos pasur mundësi të kuptohen në detaje dhe është dërguar për atë kohë.

Edhe argumenti i dytë është i pavlefshëm sepse nuk është vërtetuar ndonjë obligueshmëri për çështjet të cilat i përmendën dhe nuk janë transmetuar si obligime bindëse. Por, edhe po të pranohet se ka argumente të cilat na bindin, nuk tregohet me asgjë se ato obligime janë obligime legislative dhe se kryerësi i atyre veprimeve i ka kryer si obligime ligjore sepse e gjithë ajo çka kuptohet, kuptohet se qëllimi i kryerjes së atyre veprimeve është vetëm afrim ndaj Krijuesit, e jo si zbatues i urdhërimeve. Ka mundësi që kryerja e haxhit të jetë prej tij, namazi prej tij, umreja prej tij, madhërimi i Qabes prej tij është vetëm një begati e cila na është transmetuar në mënyrë të përgjithshme për veprimet e pejgamberëve të mëparshëm.

Përderisa, sa i përket ngrënies së mishit, prerjes së kafshëve, nënshtrimit të kafshëve, kanë qenë para ligjësimit të tyre. Gjithashtu mosngrënia e cofëtinës ka qenë natyrshmëri e tij për t'u larguar prej tyre, sikurse nuk ka pasur dëshirë të hajë mishin e ariut, mirëpo thënia se ka besuar se janë detyra ligjore nuk na është vërtetuar.

Përderisa argumentet e dy grupeve nuk kanë shpëtuar nga kritika, unë i shtoj mendimit të atyre të cilët thonë se duhet shikuar derisa të vërtetohet argumenti për njërin prej çështjeve.

Gazaliu thotë: Favorizohet mendimi se logjikisht kjo është e lejuar, mirëpo e vërteta është se nuk e dimë në mënyrë të prerë dhe të hidhet një mendim për çështje për të cilat nuk kanë ndërlidhmëni, tani është vetëm zbatimi praktik i cili nuk do të kishte kuptim.

E dyta: Pejgamberi s.a.v.s. dhe umeti i tij pas pejgamberisë së tij a e kanë për detyrë t'i zbatojnë ligjet e mëparshme.

Në çështje të akides nuk ka mospajtime, se sheriati ynë nuk i shfuqizon të gjitha ligjet e mëparshme në tërësi, pasi që nuk është shfuqizuar domosdoshmëria e besimit, ndalesa e prostitucionit, vjedhja, vrasja dhe pabesimi. Përderisa sa i përket çështjeve përpos besimit duhet të shikojmë sferën ku ka dallime dhe atë çështje janë të llojllojshme:

- Ligjet të cilat nuk janë të përmendura në ligjin tonë, as në Kur'an dhe as në sunet, pa kurrfarë diskutimi nuk janë ligje për ne.

- Ligjet të cilat i ka shfuqizuar ligji ynë, pa kurrfarë diskutimi nuk janë ligje për ne, p.sh., ndalimi i çdo shpeze sqepshqyese (kthetra shqyes), si f.v., deveja, rosa, lejleku, po ashtu ndalimi i dhjavit i cili nuk është i përzier në eshtra, ndalesa e pasurisë së luftës, ose vrasja e ndërsjellët si masë e pranimi të pendimit ose shkurtimi apo prerja e pjesës së rrobës për t'u pastruar nga pastërtia. Këto ligje janë shfuqizuar për ne.

- Ligjet të cilat i ka konfirmuar ligji ynë, pa kurrfarë diskutimi se ne e kemi për detyrë t'i zbatojmë sepse janë prej sheriatit tonë, si p.sh.,

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“U është bërë obligim agjërimi ashtu siç ka qenë obligim për ata të cilët kanë qenë para jush.” (El-Bekare : 183)

Po ashtu kurban:

“Preni kurban prej bagëtisë sepse kjo është e lejuar.” Kurban është sunet i Ibrahimit a.s. në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

وَفَدَيْنَاهُ بِذَبْحٍ عَظِيمٍ

“Dhe ne e shpërblyem me një kurban të vlefshëm dhe madhështorë.” (Es-Saffat : 107)

Ka mbetur lloji i fundit për të cilin kanë debatuar dijetarët. Ligjet të cilat sheriatit ynë nuk i ka konfirmuar, nëse ato ligje kanë qenë para nesh dhe i dimë si të sigurta por që nuk janë shfuqizuar sikurse ngjarjen të cilën e ka treguar nga pejgamberi s.a.v.s. dhe as që e ka vërtetuar, por as nuk e ka mohuar, si f.v.,:

- ajeti i hakmarrjes në sheriatin e jehudëve:

وَكُتِبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ وَالْعَيْنَ بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ وَالْأُذُنَ
بِالْأُذُنِ وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ وَالْجُرُوحَ قِصَاصٌ

“Ne u caktuam atyre në të (në Tevrat) kundërmaset ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundër masë.” (El-Maide : 45)

- dhe shembulli i ndarjes së orarit të shfrytëzimit të ujit në mes të Salihut a.s. dhe popullit të tij:

وَيَسْتَكْمِلُونَ لَهُمُ الْمَاءَ قِسْمَةً بَيْنَهُمْ ۖ كُلُّ شَرِبٍ مُحْتَضَرٌ

“Dhe lajmëroji ata se uji është i ndarë (për t’u shfrytëzuar) për ta veç e veç, secili do të paraqitet për të pirë ujë në rendin e vet.” (El-Kamer : 28)

Për llojin e tretë dijetarët janë ndarë në tri drejtime:

Drejtimi i parë: Shumica absolute e hanefijve, malikijve dhe disa shafijjë dhe sipas një transmetimi nga Ahmedî. Ky drejtim e ka bazën te shumica e sahabëve: *Ajo çka është vërtetuar në ligjet para nesh është ligj edhe për ne nëpërmjet rrugës së shpalljes te pejgamberi s.a.v.s. dhe jo nga librat e tyre të ndryshuara dhe ne e kemi obligim të veprojmë me ato ligje, përderisa nuk vërtetohet e kundërta në sheriatin tonë dhe nuk është paraqitur diçka çka nuk i pranon ato ligje.*

Drejtimi i dytë: Drejtimi i esharijve, muëtezilëve dhe shiitëve dhe i cili është dominant te shafijjtë dhe te Ahmedî sipas një transmetimi tjetër. Këtë e ka përzgjedhur Gazaliu, Amediu, Raziju, Ibn Hazmi Dhahirij dhe shumica e dijetarëve është se, *ligji para nesh* nuk është ligj për ne.

Drejtimi i tretë: Ibn Kushejrîu dhe Ibn Burhani kanë thënë se duhet të shikohet a është i sqaruar me argument të saktë. Amediu ka thënë: “Kjo është larg mendjes që të ndodhë sepse nuk ka se çka të kundërshtohet nëse ndodhë ashtu.”

Vërehet se mospajtimi i këtyre drejtimeve ka të bëjë me ata të cilët nuk e kanë mohuar zbatimin para pejgamberisë sepse ata të cilët e kanë mohuar zbatimin para pejgamberisë, ata e mohojnë edhe pas pejgamberisë.

Argumentet

Argumentet e konfirmuesve: Grupi i parë. Drejtimi i konfirmuesve argumentohet me katër argumente:

1. Është ligj prej ligjeve të cilat i ka zbritur Allahu dhe nuk ka diçka i cili dëshmon shfuqizimin e atyre ligjeve, për këtë arsye kërkohet që t'i zbatojmë në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar.

أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ ۖ فَبِهَدَاهُمْ أَقْتَدُهُ

“Ata (të dërguarit e përmendur) ishin që All-llahu i vuri në rrugë të drejtë, andaj ti merri shembull në udhëzim.” (El-En’am : 90)

Është vërtetuar nga Ibn Abasi se ai (Muhamedi a.s) ka bërë sexhde kur e ka lexuar ajetin e suretul Sad:

قَالَ لَقَدْ ظَلَمَكَ بِسُؤَالٍ نَعَجْتِكَ إِلَىٰ نِعَاجِهِ ۖ وَإِنَّ كَثِيرًا مِّنَ الْخُلَطَاءِ لَيَبْغِي بَعْضُهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَقَلِيلٌ مَّا هُمْ ۖ

وَوَظَنَ دَاوُودُ أَنَّهَا فَتَنَاهُ فَاسْتَغْفَرَ رَبَّهُ وَخَرَّ رَاكِعًا وَأَنَابَ [٣٨:٢٤]

“Ai (Davudi) tha: “Ai ka bërë padrejtësi ndaj teje me kërkimin e deles tënde (për t’ia bashkuar) te delet e veta. Është e vërtetë se shumica prej ortakëve i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, me përjashtim të atyre që kanë besuar dhe punuar vepra të mira, por të tillë janë pak!” e Davudi mendoi se Ne e kemi vënë në sprovë atë, andaj kërkoi falje nga Zoti i vet, ra i përkulur dhe u pendua.” (Sad : 24)

dhe pastaj e ka lexuar ajetin:

“Ata (të dërguarit e përmendur) ishin që All-llahu i vuri në rrugë të drejtë, andaj ti merri shembull në udhëzim.” (El-En’am : 90)

dhe po ashtu kemi ajetin:

ثُمَّ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ أَنِ اتَّبِعْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا

“Pastaj, ty të shpallëm: “Ndiqe fenë e drejtë (miletë) të Ibrahimit.” (En-Nahl : 123)

Këto dy ajete dëshmojnë dhe vërtetojnë shumë qartë argumentet e këtij drejtimi sepse **ajeti i parë** urdhëron që të pasohet udhëzimi dhe janë simbol i besimit dhe ligjeve në përgjithësi.

Ajeti i dytë urdhëron që të pasohet “**mileti**” i Ibrahimit, “**milet**” e ka kuptimin e ligjit. Urdhri tregon për obligueshmëri. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

شَرَعَ لَكُمْ مِنَ الدِّينِ مَا وَصَّىٰ بِهِ نُوحًا وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ وَمَا وَصَّيْنَا بِهِ
إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَىٰ ۚ أَنْ أَقِيمُوا الدِّينَ وَلَا تَتَفَرَّقُوا فِيهِ

“Ai u përcaktoi juve fe atë që i pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të.” (Esh-Shura : 13)

Tregon për obligueshmërinë e sheriatit të Nuhut se fjala “dijne” është emër me të cilin Zoti i Lartmadhëruar tregon për besimin dhe ligjësimin. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّا أَنْزَلْنَا التَّوْرَةَ فِيهَا هُدًى وَنُورٌ ۚ يَحْكُمُ بِهَا النَّبِيُّونَ

“Ne e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan ndaj atyre, peygamberët që ishin të bindur, (El-Maide : 44) e peygamberi s.a.v.s. është njëri prej peygamberëve.

2. Janë argumentuar me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَكَتَبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ

“Ne u caktuam atyre në të (në Tevrat) kundërmasat ndëshkuese: njeri për njeri (El-Maide : 45)

Me këtë ajet dijetarët janë argumentuar për ligjin obligativ të hakmarrjes në ligjin tonë. Po që se peygamberi s.a.v.s. nuk e ka pasur për detyrë të zbatoj ligjet para nesh, nuk do të kishte qenë i saktë argumentimi i ligjësimin të hakmarrjes për beni israilët se është obligim sipas ligjit të tyre.

3. Janë argumentuar për obligueshmërinë e faljes kaza të namazeve, pasi që pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Kush fletë, ose e harron faljen e namazit, le ta falë kaza kur t’i kujtohet.”** dhe e ka lexuar ajetin:

وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي - **“Faleni namazin për të më përkujtuar mua.”**

(Taha : 14) pasi që dihet që ky ajet ka pasur të bëjë me Musain a.s. Po mos të kishte pasur ky ajet zbatim të ligjit para nesh, atëherë ajeti nuk do të kishte vlerë. Po ashtu baza e tij është në Tevrat në ndëshkimin me ekzekutim të jehudiut.

4. Po ashtu janë argumentuar me atë çka është vërtetuar se pejgamberit s.a.v.s. i ka pëlqyer të jetë në pajtueshmëri me pasuesit e librit në çështje për të cilat nuk ka pasur shpallje. Po mos të kishte qenë ligjësimi i tyre argument, pëlqimi i tij për pajtueshmëri nuk do të kishte vlerë.

Këto argumente janë replikuar gjerësisht por ne do t’i përmendmi shkurtazi.

Këto argumente nuk tregojnë tregueshmëri të prerë për të vërtetuar atë të cilën e kërkojmë, pasi që në ajetin e parë qëllimi ka qenë udhëzim i cili ka të bëjë me të gjithë pejgamberët. Ato janë çështje të cilat nuk ndryshojnë me ndryshimin e ligjeve sepse ato janë bazë e feve dhe pjesë domosdoshmërisht vitale, si sigurimi i jetës, mendjes, paraardhësve, besimit, po ashtu qëllimi i urdhrat për të pasuar fenë e Ibrahimit sepse argument i kësaj është fundi i ajetit **“...dhe nuk ka qenë prej idhujtarëve.”** sepse idhujtaria është e kundërta e besimit në një Zot.

Pjesa e ajetit **“Me të gjykojnë pejgamberët.”** është formulim i lajmërimit dhe jo i urdhërimit. Me këto argumente dëshmohet se këto janë ajete për të cilat nuk ka divergjenca sa i përket besimit dhe pjesë e çështjeve vitale dhe nuk kanë të bëjnë me ligjet sekondare për të cilat mund të shfuqizohen me ndryshimin e kohëve dhe rrethanave.

Sa i përket hakmarrjes, është ligjësim i ligjësuar në ligjin tonë ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الْقِصَاصُ فِي الْقَتْلَى

“O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje.”
(El-Bekare : 178)

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَمَنْ اعْتَدَى عَلَيْكُمْ فَاعْتَدُوا عَلَيْهِ بِمِثْلِ مَا اعْتَدَى عَلَيْكُمْ

“Pra, kush ju sulmon juve, kthejani sulmin atij edhe ju po në atë masë.” (El-Bekare : 194)

Falja e namazeve kaza është ligj i cili i është shpallur pejgamberit s.a.v.s., vetëm se ia ka bërë me dije umetit të tij për ngjashmërinë e tij me ligjin e popullit të Musait a.s.

Sa i përket të bazuarit të pejgamberit s.a.v.s. në Tevrat, ka qenë vetëm për t’ju treguar jehudëve për obligueshmërinë e atij ligji sepse ata e mohonin atë ligjësim të gurëzimit në ligjin e tyre dhe për ta paraqitur të vërtetën e tij sepse atë që e ka treguar ka qenë e përmendur në Tevrat e jo që të përfitoj ligjësimin e gurëzimit prej tyre. Këtë e dëshmon fakti sepse përpos kësaj çështjeje në raste tjera nuk është bazuar.

Argumentet e mohuesve

Po ashtu edhe mohuesit janë argumentuar me katër argumente:

1. Kur pejgamberi s.a.v.s. e ka dërguar Muadhlin si gjykatës në Jemen dhe e ka pyetur se me çka do të gjykonte. Ai i është përgjigjur: me Kur’an, me sunet pastaj me ixhtihad, ndërsa pejgamberi s.a.v.s. ia miraton dhe nuk e ka këshilluar që të veproj me *ligj para nesh*. Po të kishte qenë detyrë për t’u zbatuar ligji para nesh, do t’ia kishte përkujtuar Muadhit, ose do t’ia kishte treguar se nëse nuk e zbaton ligjin para nesh, ai do të gabonte.

2. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَاجًا ۚ

“Ne caktuam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit).” (El-Maide : 48)

Kjo dëshmon se çdo grupi i është caktuar program dhe ligj dhe nuk kërkohet që një grup të zbatoj ligjin e tjetrit, saqë Muëtezilët kanë shkuar aq larg dhe kanë thënë se *logjikisht kjo është e pamundur*.

3. Po ta kishte pasur për detyrë pejgamberi s.a.v.s. që të zbatoj ligjin para nesh, po ashtu edhe umeti i tij do ta kishte pasur për detyrë ta mësoj atë ligj dhe do ta kishin pasur për detyrë sahabët që ta studiojnë atë dhe të bënë pyetje përbrenda kornizës së atij ligji kur do të kishte ndodhur ndonjë ngjarje për të cilin nuk do të ishin pajtuar ata në mes vete.

4. Ligjet e mëparshme kanë qenë posaqërisht për popujt e atyre pejgamberëve. Sa i përket sheriatit islam është i përgjithshëm. Është themeluar ixhmai se sheriatit është *shfuqizues* i ligjeve të mëparshme. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Më janë dhënë pesë çështje të cilat nuk i janë dhënë më herët askujt tjetër pos meje.”** prej tyre e ka përmendur atë se pejgamberi (i mëparshëm) ka qenë i dërguar posaqërisht për popullin e vet, ndërsa pejgamberi s.a.v.s. i dërguar për të gjithë njerëzimin. Po ta kishte pasur për obligim që pejgamberi s.a.v.s. të zbatoj ligj të mëhershëm, ai do ta fuqizonte atë e jo ta shfuqizonte.”

Po ashtu këto argumente janë replikuar si në vijim:

Ligji para nesh nuk është përmendur në hadithin Muadhrit sepse Kur’ani e përfshinë në vete ose që ajo është e përkufizuar në çështje të pakta, dhe se pejgamberi s.a.v.s. dhe shokët e tij pas tij nuk janë kthyer në librat e mëparshme ose për shkak të deformimit të tyre, ose për shkak të ndryshimit të tyre, dhe se muxhtehidët duhet të hulumtojnë çështje të cilat nuk janë të përmendura në Kur’an. Kështu që nuk ka diskutim se nuk ka arritur të plotësohet kjo çështje.

Sa i përket ixhmailit se sheriatit ynë është shfuqizues i ligjeve të mëparshme, nuk ka të bëjë me të gjitha çështjet e sheriatit, sepse është shfuqizues i atyre me të cilat është atakuar, kjo për faktin e mbetjes në fuqi të ligjësimi të hakmarrjes dhe dënimit për prostitucion.

Kjo, dhe shumica e ekspertëve bashkëkohorë të usulit e favorizojnë drejtimin e atyre të cilët deklarojnë se ligji para nesh është ligj edhe për ne me kusht që ai ligj të vërtetohet saktësisht prej të drejtëve, të saktëve dhe prej muslimanëve të cilët e transmetojnë saktësisht ose që ai ligj të jetë prezent edhe në Kur'an, ose që të jetë i transmetuar me sunetet e sakta sepse ato janë ligje qiellore dhe se përmendja e atyre ligjeve në Kur'an, pa i mohuar dhe duke mos i shfuqizuar dëshmon për ligjësimin e tyre dhe fuqizimin e tyre edhe për ne dhe se Kur'ani vërteton Tevratin dhe Inxhilin. Bazuar në këtë, dijetarët kanë lejuar që të mirat që mund të shfrytëzohen bashkërisht me orare të caktuara. Këtë formë e tregon Kur'ani me ngjarjen e Devesë së Salihut a.s.:

وَنَبِّئُهُمْ أَنَّ الْمَاءَ قِسْمَةٌ بَيْنَهُمْ ۖ كُلُّ شَرِبٍ مُحْتَضَرٌ

“Dhe lajmëroji ata se uji është i ndarë për ta veç e veç, secili do të paraqitet për të pirë ujë në rendin e vet.” (El-Kamer : 28)

Kjo është formë e shfrytëzimit (të ujit) me orare të caktuara. Këtë e lejojnë që të katër medhhebet. Hanefijtë janë argumentuar për lejimin e ekzekutimit të muslimanit për minorenin dhe për ekzekutimin e mashkullit për femrën me ajetin kur'anor: **“Dhe u kemi bërë obligim atyre njeri për njeri.”** Që do të thotë se kjo ka qenë në Tevrat. Po ashtu me këtë ajet janë argumentuar Malikijtë dhe Hanbelijtë për ekzekutimin e mashkullit për femrën. Malikijtë, Shafijtë dhe Hanbelijtë janë argumentuar për lejimin e “pengmarrjes” në thënien e Zotit të Lartmadhëruar në suretu Jusuf:

وَلِمَنْ جَاءَ بِهِ حِمْلُ بَعِيرٍ وَأَنَا بِهِ زَعِيمٌ

“...e kush e sjell atë (tasin), ka (shpërblim) një barrë deveje (drithë). Unë vet jam për këtë garantues!” (Jusuf : 72)

Joshafijtë janë argumentuar për lejimin e garancionit material me atë njerëzor me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

قَالَ لَنْ أُرْسِلَهُ مَعَكُمْ حَتَّى تُؤْتُونِ مَوْثِقًا مِّنَ اللَّهِ لَتَأْتَنَّنِي بِهِ

“Ai (Jakubi) tha: Unë kurrësi nuk e dërgoj atë me ju, derisa të më jepni besën (e fortë) në All-llahun, se gjithësi do të ma ktheni atë mua, përveç nëse u diktojnë rrethanat e nuk mundeni. ...”(Jusuf : 66)

Shafiijtë bazohen me këtë ajet dhe janë argumentuar me hadithin **“Udhëheqësi dënohet.”** dhe me kjasin për zbatimin e borxhit.

Hanbelijtë janë argumentuar që mehri të jetë një formë shërbimi që sjell dobi duke u bazuar me ajetin:

قَالَ إِنِّي أُرِيدُ أَنْ أَنْكِحَكَ إِحْدَى ابْنَتَيَّ هَاتَيْنِ عَلَى أَنْ تَأْجُرَنِي ثَمَانِي
حِجَجًا ۖ فَإِنْ أَتَمَمْتَ عَشْرًا فَمِنْ عِنْدِكَ

“Ai (Shuajbi) tha: Unë dëshiroj të martojë ty me njërën prej këtyre dy vajzave të mia, me kusht që të shërbesh tetë vjet, e nëse i plotëson dhjetë, ai është vullneti yt...!” (El-Kasas : 27)

Shafiijtë e argumentojnë këtë ajet dhe argumentohen për lejimin e kësaj forme duke krahasuar me qiranë.

Imam Maliku, për favorizimin e mishit të dashit, pas saj vjen mishi i lopës, pastaj i devesë, është argumentuar me veprimin e Ibrahimit a.s. kur e ka sakrifikuar dashin në vend të djalit të tij.

Maliku, Ebu Hanife dhe Muhamedi (me përjashtim të Shafiijut, Ahmedit, Ebu Jusufit dhe Zuferit) argumentohen me tregimin e Ibrahimit a.s. për t’u detyruar që për përбетim në fëmijën të prehet delja.

Sipas mendimit tim, për të komentuar atë që u tha është argument i pavarur i argumenteve të sheriatit, por është brenda kornizës së Kur’anit dhe sunetit, sepse siç e kuptuam nuk veprohet me të përpos në rastet të cilat i ka treguar Zoti i Lartmadhëruar ose i dërguari i tij, pa i shpallur të pavlefshme dhe nuk ka diçka në sheriatin tonë e cila i ka shfuqizuar ato. Pra, e vërteta është se ligji para nesh nuk është ligj i pavarur për ne.

Medhhebi i sehabiut

Para se të filloj këtë temë duhet të sqaroj definicionin e sehabiut.

Te shumica absolute e usulistëve, **sehabi quhet ai i cili e ka takuar të dërguarin s.a.v.s. si besimtarë dhe ka qëndruar me të një interval të gjatë kohorë.**

Te shumica absolute e muhadithinëve, **sehabe quhet ai i cili e ka takuar si musliman dhe ka vdekur si musliman, pa marrë parasysht a ka qëndruar gjatë me të apo jo.**

Sehabet kanë qenë çerdhe e fetvave dhe bazë e ixhtihadit, atëherë kur janë paraqitur çështje të reja dhe kanë ndodhur ngjarje të cilat nuk kanë qenë në kohën e pejgamberit s.a.v.s. sehabet varësisht prej pjekurisë së tyre në fetvatë e tyre kanë pasur pikëpamje të ndryshme, në fikh.

Nga një pjesë e tyre janë gjetur shumë fetva, sa që po të tuboheshin të gjitha do të ishte një enciklopedi prej tyre, por fatkeqësisht vetëm një pjesë e tyre janë të regjistruara në libra të fikhut. Ah, sikur të tuboheshin të gjitha ato fetva dhe të përfitonim prej tyre në fusha të ndryshme!

Muxhtehidët, nga të gjitha medhhebet pa përjashtim, **janë pajtuar** se pranohet mendimi i sehabiut në çështje për të cilat nuk kanë të bëjnë me mendimin apo ixhtihadin e tyre sepse ajo i takon çështjes së përputhshmërisë së mendimit të tyre me mendimin e të dërguarit të shpalljes, Muhamedit s.a.v.s.

Po ashtu **janë pajtuar** në atë, për të cilën të gjithë sehabet deklarativisht janë pajtuar ose që nuk dihet që ndonjëri prej tyre ka kundërshtuar siç është rasti i çështjes së trashëgimisë së gjysheve një të gjashtën.

Po ashtu **janë pajtuar** se mendimi i sehabiut në bazë të ixhtihadit për ndonjë çështje prej shumë çështjeve i cili ka rezultuar në papajtueshmëri në mes tyre nuk është argument, sepse po të kishte qenë argument mendimi i njërit për tjetrin nuk do të ndodhnin në mes tyre mendimet e ndryshme.

Mospajtimi në mes dijetarëve ka të bëjë me mendimin e tyre në bazë të ixhtihadit për tabiinët dhe për gjeneratat pas tyre? A konsiderohet argument apo jo?

Analiza e mendimeve të dijetarëve sa i përket medhhebit të sehabiut

Sa i përket medhhebit të sehabijut, dijetarët kanë përmend katër mendime.

Mendimi i parë: Medhhebi i sehabijut nuk është argument. Ky është drejtimi i shumicës absolute të esharijve, muëtezilëve, shiitëve, Shafijut dhe mendimit më prioritarë të shafijëve, sipas një transmetimi edhe nga Ahmed. Këtë mendim e kanë përzgjedhur edhe dijetarët e mëvonshëm hanefijë dhe malikijë.

Sa i përket Ibn Hazmit, ai nuk ka pranuar të veprohet me mendimin e sehabijut, duke u bazuar në atë se nuk lejohet të pasohet askush, as prej sehabëve e as prej tjerëve përpos tyre.

Mendimi i dytë: Medhhebi i sehabiut është argument i sheriatit dhe ka përparësi ndaj kijasit. Të këtij mendimi janë dijetarët hanefijë, është transmetuar nga Maliku dhe nga Shafijju, nga medhhebi i tij i vjetër dhe nga Ahmed i nga një transmetim tjetër dhe ka përparësi në medhhebin e tij.

Kështu shihet se është mendim i shumicës absolute të dijetarëve ashtu siç thuhet në librat e autorëve bashkëkohor.

Mendimi i tretë: Medhhebi i sehabiut është argument nëse mendimit të tij i bashkëngjitet kijasi. Kështu i jepet përparësi ndaj mendimit të sehabiut tjetër.

Mendimi i katërt: Mendimi i sehabiut është argument nëse kundërshtohet me kijasin, vetëm nëse ai mendim e nxjerrë atë lajm dhe e pason atë, se përndryshe anashkalohet kijasi për të cilin jemi të urdhëruar për të vepruar, kritikohet vërtetësia e tij dhe kjo është e patolerueshme, e atëherë mendimi i tij është argument.

Shihet qartë se ky mendim është prej drejtimit hanefijë.

Hanefijtë e kanë përzgjedhur se për këtë temë duhet të selektohet:

- Nëse mendimi i sehabiut është mendim i cili nuk ka të bëjë me mendimin e lirë dhe të ixhtihadit, llogaritet argument, sepse është e mundur që atë mendim e ka dëgjuar nga pejgamberi s.a.v.s. si p.sh., mendimi i transmetuar nga disa prej sehaveve për disa përcaktime të fazave kohore, si f.v., përcaktimi se maksimumi i shtatzënisë është dy vite, transmetim i transmetuar nga Aishja r.a. Përcaktimi se minimumi i menstruacionit është tri ditë, transmetim i transmetuar nga Ibn Mes'udi dhe Enesi.

Përderisa për mendimin i cili është nga mendimi i lirë është thënë se është argument dhe anashkalohet kijasi me të. I këtij mendimi është Seid el Berdaj sepse ka përparësi mendimi i cili është e mundur se është dëgjuar nga pejgamberi s.a.v.s. Është thënë se nuk është argument dhe është thënë se ky mendim është i Kerhijut sepse nuk ka prioritet mundësia e dëgjimit nga pejgamberi s.a.v.s. pasi që sehabet kanë qenë muxhtehid dhe ixhtihadi mund të mos jetë i drejtë ndërsa po të ishte transmetim ai do ta deklaronte se e ka dëgjuar pejgamberin s.a.v.s.

Sipas mendimit tim të gjitha këto katra-pesë mendime mund t'i përmbledhim në dy drejtime:

Drejtimi i parë: Mendimi i sehabiut është argument, të këtij drejtimi janë hanefijtë, malikijtë dhe hanbelijtë.

Drejtimi i dytë: Mendimi i sehabiut nuk është argument, të këtij drejtimi janë shafijjtë.

Sa i përket asaj se nëse mendimi i sehabiut përputhet me kijasin, atëherë argument do të ishte kijasi, kështu imam Shafijju në medhhebin e ri është prej penguesve të mendimit të sehabiut ashtu siç e kanë konfirmuar dijetarët shafijjë, vetëm se kjo nuk i përgjigjet asaj çka është shkruar në shkresën e tij ku thotë: ***“Prej mendimit të sehabiut është ajo çka përputhet ose me Kur'anin, ose me sunetin, ose me ixhmain, ose që është më i saktë se kijasi.”*** Po ashtu ka thënë: “Unë e përkrahi të pasohet lajmi i vetëm, nëse nuk gjej në Kur'an, në sunet apo ixhmaë, apo diçka të ngjashme e cila ka kuptimin me të cilin mund të gjykohet ose që me të gjendet kijasi dhe vështirë se mund të gjendet diçka prej lajmit të vetëm i cili është në kundërshtim me ato të cilat i ka thënë (Shafijju).”

Sa i përket mendimit se është argument nëse është në kundërshtim me kijasin apo nëse është mendim i cili nuk ka të bëjë me mendimin e lirë ose me ixhtihadin. Kjo nuk është çështje e cila debatohet, sikurse u vërtetua në fillim se atëherë do të ishte të vepruarit me sunet.

Sa i përket imam Ahmedit. Në librin “**Tēlamul Mukijjnē**” Ibn Kajimi ka thënë se veprohet me mendimin e sehabiut. Kjo është e konfirmuar prej tij. Ai i ka llogaritur fetvatë e sehabëve në vendin e dytë pas sunetit të saktë dhe i jep përparësi ndaj hadithit mursel dhe të dobët. Hadith i dobët është hadithi që në fillim të rrugës së vet ka qenë i dobët dhe i vetmuar por që më vonë i janë shtuar rrugët e tij të cilat rrugë e kanë ngritur në hadith Hasen (i mirë).

Sa i përket imam Ebu Hanifes, ai vepron me mendimin e sehabiut dhe i jep prioritet ndaj kijasit, ndërsa e kundërta është ajo që kanë transmetuar disa prej studentëve të tij për të se Ebu Hanife i jep prioritet mendimit të lirë ndaj mendimit të sehabiut duke u bazuar në disa çështje dytësore në medhhebin e tij. Argument është edhe vet thënia e tij: ***Nëse nuk e gjej në librin e Allahut dhe as në sunetin e të dërguarit të Allahut, veproj me mendimin e sehabiut. E marr çka dëshiroj prej tyre dhe nuk e marr çka nuk e dëshiroj prej tyre. Nuk kaloj prej mendimit të tyre tek të tjerët.***

Argumentet e dijetarëve për argumentimin me mendimin (medhhebin) e sehabiut

Argumentet e mohuesve

Ata të cilët deklarojnë se mendimi i sehabiut nuk është argument janë argumentuar si në vijim:

1. Argument nga Kur'ani

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِيَ الْأَبْصَارِ

“Dhe logjikoni o ju të zotët e mendjes.” (El-Hashr : 2)

Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar të zotët e mendjes të logjikojnë, që do të thotë të bëjnë ixhtihad. E kjo është në kundërshtim me pasimin sepse ixhtihadi është të hulumtuarit në argumente. Pasim është të vepruarit me mendjen e tjetrit pa argument: Po të kishte qenë dashur të pasohet medhhebi i sehabiut atëherë do të duhej t'i jepej përparësi ndaj kijasit sepse bazohet në transmetim dhe dëgjim, ndërsa bazë është që teksti i transmetuar i cili ka përparësi ndaj kijasit mirëpo siç është e ditur te dijetarët kijasi ka përparësi ndaj mendimit të sehabiut sepse kijasi është në kategorinë e katërt pas Kur'anit, sunetit dhe ixhmait. Ky është argumenti më i fortë në argumentimin e medhhebit të tyre.

2. Argument nga Ixhmai.

Janë pajtuar sahabët se është e lejuar ta kundërshtojnë njëri-tjetrin, dhe po të kishte qenë argument i njërit prej tyre për tjetrin do të kishte qenë obligative që secili prej tyre ta pasoj njëri-tjetrin, me fjalë tjera, do të ishte mohuar mendimi i tjetrit i cili e ka kundërshtuar.

Ky argument replikohet se nuk është boshti i temës sepse siç u pa në fillim të temës, çështja është për te jo-sahabët. Kjo do të thotë: se a është argument mendimi i sehabiut për ata të cilët vijnë pas tyre, pra për tabiünët dhe për të tjerët të cilët vijnë pas tyre dhe jo për ixhtihadin e tyre për njëri-tjetrin.

3. Argumenti logjik.

Sehabiu është pjesëtarë i ixhtihadit, e muxhtehidi lejohet të gabojë, ose të harroj, dhe nuk lejohet që tabiiju muxhtehid ose muxhtehidi pas tij të pasoj medhhebin e sehabiut. Ai i cili e transmeton mendimin e tij, nuk e ngrit në nivelin e “**HABERIT MERFUË**” (thënie e tij si hadith por pa e treguar se ka thënë Muhamedi a.s.). Kështu që nuk i jepet përparësi mendimit të tij ndaj kijasit, pasi që mund të ketë gabuar.

4. Sehabët e kanë pranuar ixhtihadin prej tabiinëve. Ka ndodhur që tabiinët i kanë kundërshtuar mendimet e medhhebit të sehabiut. Po të kishte qenë mendimi i sehabiut argument për të tjerët nuk do të kishte pasur rëndësi ixhtihadi i tabiijut dhe sehabiu nuk do të duhej të mos e prante mendimin e tij.

Të kësaj natyre ka shembuj të shumtë, e prej atyre shembujve po ilustrim rastin kur Aliu r.a. ishte në proces gjyqësor për mburojë e tij të cilën e gjeti me jehudiun të Sherijhu.

Umeri r.a. ishte prokuror i atij procesi dhe nuk iu pranua dëshmia e Hasanit për shkak të afërsisë.

Përderisa Aliu r.a. e konsideronte të lejuar dëshminë e djalit për babën e tij.

Mesruk Ibn Abasi r.a. e ka kundërshtuar mendimin e sakrifikimit të fëmijës për shkak të përбетimit. Ibn Mesruku e kishte paraparë sakrifikimin e një deleje, përderisa Ibn Abasi e ka paraparë sakrifikimin e njëqind deveve. Mesruki i ka thënë se djali i tij nuk është më i vlefshëm se Ismaili a.s. Atëherë Ibn Abasi e ka pranuar mendimin e Mesrukit.

Kur është pyetur Enes bin Maliku për ndonjë çështje ai ka thënë: ***Për këtë çështje pyeteni të nderuarin tonë Hasanin.*** Kjo dëshmon se mendimi i sahabijut nuk është argument për të tjerët.

Argumentet e pranuesve të mendimit të sehabiut

Deklaruesit se mendimi i sehabijut është argument argumentohen me argumente tjera:

1. Argument nga Kur'ani.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ
وَتُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ ۚ وَلَوْ آمَنَ أَهْلُ الْكِتَابِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ ۚ مِّنْهُمْ الْمُؤْمِنُونَ
وَأَكْثَرُهُمُ الْفَاسِقُونَ [٣:١١٠]

“Je jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun. E, sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, por shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.” (Ali Imranë : 110)

Ky ajet i kushtohet sehabëve r.a. Dëshmon se çka urdhërojnë ata, urdhërojnë për të mirë. Urdhërimi për të mirën duhet të pranohet.

2. Argument nga Suneti.

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “Gjenerata më e mirë është gjenerata në të cilën jam unë.”

Gjithashtu kujtojmë hadithin me të cilin argumentohen disa ekspert të hadithit: “Sehabet e mi janë si yje, në cilindo prej tyre që mbështeteni, do të udhëzoheni.”

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Mbështetuni me ata të cilët janë pas meje, në Ebu Bekrin dhe në Umerin.” dhe ky hadith nuk mund të specifikohet në atë se duhet t'i pasojnë sehabet tjerë në përgjithësi sepse atëherë do të ishte specifikim pa argumentim, sepse ashtu nuk do të kishte vlerë që sehabët të mbështeten te sehabet, pasi që janë pajtuar dijetarët se lejohet që njerëzit e rëndomtë të pasojnë çdo muxhtehid përpos sehabet dhe nuk mbetet tjetër pos që qëllimi i këtyre haditheve është se duhet të pasohet mendimi i tyre.

3. Argumenti logjik.

Medhhebi i sahabiut është bërë argument ngase është e mundur të respektohet mendimi i sehabiut dhe për arsye se ato mund të kenë mendim të drejtë për shkak të shoqërimit me pejgamberin s.a.v.s. dhe kur sehabin e thotë një mendim i cili është në kundërshtim me kijasën, atëherë ose ka bazë në të ose nuk ka bazë në të dhe:

- është e pamundur që të mos ketë bazë sepse atëherë ai do të thoshte diçka në shariat pa argumentim dhe kjo është e ndaluar dhe sehabet do t'i kishim zhveshur nga drejtësia dhe vlera e tyre.

Nëse kanë bazë, nuk ka bazë tjetër përpos kijasit dhe të transmetuarit, e atëherë është argumentim i cili duhet të bazohet sepse është të vepruarit me mendimin e sehabiut i cili do të ishte në krah të favorizimit të lajmit (hadithit) të vetmuar ndaj kijasit.

Të gjitha këto argumente janë replikuar:

Ajeti i lartpërmendur i kushtohet sehabëve në përgjithësi dhe nuk është e domosdoshme që nëse pasohen në atë çështje për të cilën pajtohen të gjithë të pasohen për një mendim të njërit apo të dy sehabëve.

Sa i përket hadithit **“Sehabët e mi janë si yjet...”** asnjëherë nuk është vërtetuar. Tema për to është e njohur te muhadithinët. Por edhe po që se presupozojmë se është vërtetuar, kuptimi i saj do të ishte se ata janë shembull në pasimin e shariatit dhe të vepruarit me ta për shkak të pasionit të fortë të tyre për të pasuar dhe për të shkuar drejt saj. Këtë kuptim e ka edhe hadithi tjetër: **“Mbështetuni në ata të cilët janë pas meje.”** Përmbajuni sunetit tim dhe sunetit të halifeve të drejtë pas meje, bile kuptimi i këtyre haditheve nuk ka të bëjë në pasimin e përgjithshëm të tyre në çdo çështje, por ka të bëjë me atë (hadithin) të cilën e transmetojnë, nuk ka përparësi transmetimi i ndokujt tjetër para transmetimit prej tij.

Sa i përket argumentit logjik – vet argumentimi tregon se ka të bëjë me tabiun edhe pse të gjithë e dimë se dijetarët janë pajtuar se mendimi i tabiut nuk është argument sa i përket asaj se mund të ketë pasur ndikim koha që ata të jenë pjesë e argumentit nuk është e vërtetë sepse nuk ka ligj pos ligjit të shariatit.

Mendimi prioritarë

Unë i jap përparësi mendimit se mendimi i sehabiut nuk është argument i pavarur i shariatit, nëse është mendimi i tij i cili bazohet në mënyrë absolute me ixhtihadin e tij sepse muxhtehidi mund të gaboj. Nuk është vërtetuar se sehabët i kanë detyruar të tjerët të pasojnë mendimet e tyre për shkak të nivelit të shoqërimit me Muhamedin a.s. Edhe pse ata kanë vlerë të madhe, kjo nuk i bën ata që të mos gabojnë.

Sa i përket atyre të cilët deklarojnë se mendimi i sehabiut është argument, u vërejtën anët e dobëta të tyre, po e veçoj thënien e tyre: Të dhënurit prioritet se e ka dëgjuar nga pejgamberi s.a.v.s., ky është vetëm paragjykim, por në realitet nuk peshon mendimi për atë. Alternativa ekziston, sepse është e mundur se deklarimi (mendimi) i tij është i bazuar në atë se ai (sehabiu) ka menduar se është argument, mirëpo në esencë nuk ka qenë ashtu. Nëse presupozojmë se e ka dëgjuar nga pejgamberi s.a.v.s. atëherë nuk kemi çka të kundërshtohemi, sepse atëherë ai është argumentim i sunetit. Përderisa sa i përket asaj çka nuk e ka dëgjuar prej pejgamberit s.a.v.s. por prej ixhtihadit të tij të lirë, kjo është një temë e cila duhet të shikohet si për çdo muxhtehid nga të gjitha kohët.

Në lidhje me këtë, mendimi i mëparshëm, se mendimi i sehabiut për një çështje ka përparësi ndaj mendimit të ixhtihadit të tjerëve, më së miri është që këtë temë ta përfundojmë me thënien e shkëlqyer të Shevkanijut në lidhje me medhhebin e sehabiut, ku thotë: ***“E vërteta është se nuk është argument. Për këtë umet Zoti i Lartmadhëruar e ka dërguar vetëm Muhamedin s.a.v.s. dhe ne e kemi vetëm një të dërguar, një libër dhe i gjithë umeti janë të urdhëruar ta pasojnë librin e Tij (Kur’anin) dhe sunetin e pejgamberit të Tij.”***

Në këtë çështje nuk ka dallim në mes të sehabëve dhe atyre të cilët vijnë pas tyre. Që të gjithë janë të ngarkuar me ligjet e shariatit dhe pasimin e Kur’anit dhe të sunetit. Kush thotë se: “Në fenë e Allahut të Lartmadhëruar ka argumente tjera përpos librit të Allahut dhe sunetit të tij dhe çka bazohet në ta, ai ka thënë në fenë e Allahut atë që nuk është vërtetuar dhe ai ka shtuar në shariatin islam ligj të cilin nuk e ka urdhëruar Allahu. E kjo është çështje serioze dhe e rrezikshme sepse ligji i një individi apo më shumë individëve prej robërve të Allahut se mendimet e tyre janë argument për muslimanët dhe duhet të veprohet me ta dhe ashtu që të bëhet ligj i cili ndërmerr përfshirje në shoqëri e që nuk është prej fesë së Allahut.

Muslimani as nuk duhet të mbështetet dhe as të veproj me të. Këtë pozitë dhe kompetencë e kanë pasur vetëm të dërguarit e Allahut të cilët i ka dërguar me ligje për robërit e tij e jo të tjerët, të cilët edhe nëse arrijnë dituri dhe vlerë të lartë nuk mund ta kenë këtë pozitë.

Nuk ka dyshim se pozita e sehabëve është e lartë, por kjo ka të bëjë me vlerën, respektin dhe nivelin e tyre, padyshim se kjo është e papranueshme. Edhe pse asnjëri prej tjerëve nuk mund të arrij nivelin e lartë të tyre, prapëseprapë kjo nuk do të thotë që ata e kanë pozitën e të dërguarit të Allahut në argument dhe t'i obligojmë të tjerët që ta pasojnë atë. Këtë nuk e ka lejuar Allahu dhe asnjë fjalë për ta nuk është thënë në lidhje me këtë çështje.

Ibn Haxhib el Malikiju ka thënë: Janë pajtuar se medhhebi i sehabiut nuk është argument për sehabiun, e po ashtu është mendim i drejtë se *nuk është argument as për të tjerët*.

Përmbajtja:

Ligji para nesh.....	2
Medhhebi i sehabiut	16
Analiza e mendimeve të dijetarëve sa i përket medhhebit të sehabiut.....	17
Argumentet e dijetarëve për argumentimin me mendimin (medhhebin) e sehabiut	20